


PROCEDIMET E KSHPK PËR PUNËSIMET NË SEKTORIN PUBLIK: PROCEDIME TË PA PARASHIKUESHME ME EPILOG TË PA SIGURT

Autori: Dr. Sllagjana Taseva



Projekti "Monitorimi i Suksesit të Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni" është financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e grantit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Impresum

Titull: PROCEDIMET E KSHPK PËR PUNËSIMET NË
SEKTORIN PUBLIK: PROCEDIME TË PA
PARASHIKUESHME ME EPILOG TË PA SIGURT

Autori: Dr. Sllagjana Taseva

Botues: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Design: Matea Londza Shumkovska

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.antikorupcija.mk/>

Projekti "Monitorimi i Sukselit të Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni" është financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e grantit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Hyrje

Kjo është analizë e shkurtër tematike bashkëngjitur analizës periodike për përmirësimin e efikasitetit të punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin në vijim KSHPK ose Komisioni Shtetëror).¹ Ky Raport shtesë i referohet procedimeve, përkatësisht punës së KSHPK-së ndërmjet 1 janarit dhe 30 qershorit 2020. Qëllimi i kësaj analize është të shqyrtojë vëllimin e punës së KSHPK-së në fushën punësime, përmbajtjen e atyre lëndëve, mënyrën e procedimit dhe rrjedhën e procedurës për lëndët dhe vendimet e marra.

Me këtë analizë, hyjmë më thellë në temën punësime, përmes analizës së procedimeve të KSHPK-së.

Kjo çështje është me interes të veçantë duke pasur parasysh se punësimet në sektorin publik janë problem horizontal në të gjitha Programet e deritanishme për parandalimin e korrupsionit nga 2003 deri më sot, me aktivitete të shumta të planifikuara, por të pa implementuara deri në fund.

Teksti përmban edhe rekomandime për atë se si mund të përmirësohet efikasiteti i Komisionit Shtetëror, në përgjithësi dhe brenda kësaj fushe, por gjithashtu edhe se si KSHPK-ja, mund të forcojë efikasitetin dhe ndikimin e saj në përmirësimin e gjendjes dhe zvogëlimin e rrezikut nga korrupsioni në lidhje me punësimet.

Përshkrim i problemit

Sot, në periudhë prej 17 vjet nga miratimi i Programit të parë shtetëror në qershor të vitit 2003 dhe Strategjisë së re Nacionale për luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2020-2024² përsëri u konfirmua se rreziku nga korrupsioni në punësimet është shumë i lartë për shkak të të cilit është e nevojshme të fillohet krijimi i zgjidhjeve

sistimore për zvogëlimin / eliminimin e tyre.³ Duke qenë se punësimet në sektorin publik identifikohen si procese që gjenerojnë më shumë rreziqe për korrupsion dhe ndërsa forma e tyre është e njëjtë në të gjithë sektorët / sferat përkatëse të shoqërisë, ato adresohen në mënyrë të veçantë në Strategjinë, në Kapitullin 4.

¹ Martina Ilievaska dhe Popoviq Misha. "Raporti mbi punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit: janar-qershor 2020". 2020. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3bpqvd3>

² <https://www.dksk.mk/index.php?id=118&L=536>

³ Ibid, f. 7

Kompetenca ligjore e KSHPK-së

Kjo çështje është rregulluar posaçërisht në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesit⁴ ku në kapitull të veçantë rregullohet ndalimi për "Ndikim gjatë zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit në pozita udhëheqëse". Parti politike ose person që vepron në emër të partisë politike nuk duhet të kryejë ndikim gjatë punësimeve, sistematizimit dhe pushimit të marrëdhënies së punë të personit zyrtar.⁵ Komisioni shtetëror mund të kërkojë nga organi kompetent të shqyrtojë ose anulojë vendimet për punësim, ndërsa institucioni është i detyruar të veprojë sipas kërkesës së komisionit. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, Komisioni Shtetëror ka qasje në bazat e të dhënave të cilat i udhëheqin organe dhe institucione të tjera, përfshirë bazën e të dhënave të Agjencisë për Punësim.

Ligji parashikon gjithashtu masa të tjera në lidhje me praktikat korruptive dhe konfliktet e interesit në lidhje me punësim ose dobi të ngjashme. Kështu, ligji parashikon kufizim prej tre vjet kundër mundësisë që persona zyrtarë të punësohen ose të fitojnë pronësinë në ndërmarrjet ku kanë kryer mbikëqyrje. Njëkohësisht, ekziston një kufizim dy-vjeçar për punën ose përfaqësimin e subjekteve të sektorit privat me të cilët personi zyrtar ka krijuar marrëdhënie afariste.

Të gjitha këto çështje janë në kompetencë të Komisionit Shtetëror. Shtrohet pyetja se sa dhe nëse këto çështje janë dhe duhet të rregullohen paraprakisht me ligje dhe akte të tjera ligjore në mënyrë që KSHPK-së, të veprojë mbi to dhe të marrë vendime të bazuara në ligj. Kjo çështje, gjithashtu do të adresohet në këtë analizë, veçanërisht në lidhje me vendimet e KSHPK-së.

⁴ Gazeta Zyrtare e RM, nr. 12 i datës 19.1.2019 Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesit

⁵ Neni 41 (1).

Vendimet e miratuara dhe efikasiteti dhe efektiviteti i KSHPK-së

Çfarë vendimesh ka miratuar KSHPK-ja?

Nga 196 lëndë për të cilat KSHPK-ja ka vepruar në periudhën janar-qershor 2020, 89 ishin në temën e punësimit. Nga këto raste, për 36 lëndë u konkludua se nuk ka korrupsion dhe konflikt interesi, për 16 lëndë të paraqitura nuk kishin informacion të mjaftueshëm për të vepruar, për gjithsej 8 lëndë kanë konkluduar se nuk kishin kompetenca, 10 lëndë ishin referuar ose zgjidhur nga institucione të tjera dhe 2 lëndë janë vlerësuar si të vjetruara. Për 11 lëndë është iniciuar procedurë e mëtejshme, për 2 lëndë është iniciuar procedurë kundërvajtëse dhe në 4 raste është hequr konflikti i interesave.

Rastet në të cilat Komisioni Shtetëror ka konkluduar se nuk ka korrupsion dhe konflikt interesi,

gjithashtu mund të konsiderohen të zgjidhura, por nevojitet analizë më e hollësishme e përmbajtjes së atyre lëndëve, që të konkludohet sa dhe çfarë efekti është arritur gjatë realizimit të kompetencës së Shtetit Komisioni me ato veprime.

Sipas të dhënave të analizuara mbi efikasitetin e veprimit, Komisioni Shtetëror, Komisioni Shtetëror nga të gjitha rastet për të cilat ka vepruar, procedim efikas i zgjidhjes së gjendjeve të konfliktit të interesave ka realizuar në vetëm katër nga lëndët. Për më tepër, duhet të shihet epilogu i procedurave të iniciuara për kundërvajtje.

Kohëzgjatja e procedurave

Një element që duhet të përfshihet në analizën e punës së Komisionit Shtetëror dhe në atë kuadër edhe procedurat që lidhen me punësimin, është sigurisht koha në të cilën është vepruar në lidhje me këto raste. Sipas statistikave bazuar në kohën nga regjistrimi i lëndës deri në datën e zgjidhjes, Komisioni Shtetëror ka punuar mesatarisht 250 ditë për secilën nga këto lëndë. Ka raste në të cilat procedura ka zgjatur më shumë se 400 ditë, vetëm një lëndë u zgjidh për 59 ditë.

Analizë e tre lëndëve për të cilat KSHPK-ja, ka vepruar në fushën e punësimit

Lënda 1⁶: Seanca 31, 12 qershor 2020, denoncim nr. 12-1588 / 2 **refuzohet** sepse sipas KSHPK-së, veprimi paraqet mobing, ndërsa aktvendimi për sistematizimin është marrë në janar, përkatësisht para zgjedhjeve, në lidhje me të njëjtën për ankesë ka vepruar edhe Komisioni për Vendimmarrje për Ankesa nga Nëpunës Administrativ, i cili ka marrë vendim se ankesa nuk është e bazuar. Procedura zgjati 98 ditë.

Lënda 2⁷: Seanca 31, 12 qershor 2020, denoncimi nr. 12-1263 / 3, **procedura pezullohet** sepse nuk ka elemente për veprim kompetent të KSHPK-së. Denoncimi është paraqitur më 6 nëntor 2019 nga kryetari i komunës së Krivogashtani kundër tani më drejtorit të shkarkuar u.d., të ndërmarrjes komunale

për sistematizimin e paligjshëm të një personi të punësuar. KSHPK-ja, në lidhje me këtë denoncim ka vepruar më shumë se shtatë muaj, gjatë të cilit u zhvillua procedurë për përcaktimin e gjendjes faktike dhe kontrollim të bazës së pretendimeve. Për të vërtetuar pretendimet **janë konsultuar disa ligje** me të cilët rregullohet materia të cilës i referohet procedura dhe është **bërë këqyrje në vendimet e miratuara më parë**. Procedura është ndërprerë sepse KSHPK-ja, konstaton se parashtruesi nuk mundi të konfirmojë dyshimet për veprim korruptiv. Mirëpo, njëkohësisht konkludon se personat zyrtarë kishin mundësi të raportojnë te shkeljet gjatë sistematizimit të personit të punësuar t'i paraqesin te mbikëqyrja inspektuese, përkatësisht gjen se **nuk janë ndërmarrë të gjitha veprimet**.

Lënda nr. 3⁸: Seanca 30 - vazhdimi i parë i mbajtur më 18.5.2020. Komisioni veproi në lidhje me lëndën 09-1071 / 12. Lënda ka të bëjë me SHA Aeroporte të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Çështja është e hapur **me iniciativën** e KSHPK-së, për shkak të ekzistimit të indikacioneve për ndikim mbi punësimin e një personi të afërt me një funksionar të caktuar. Lënda filloi në 6.3.2019 dhe procedura para KSHPK-së, zgjati një vit e dy muaj ose më saktësisht 442 ditë. Procedura ka filluar në përputhje me nenin 32 paragrafi 1, përkatësisht me iniciativë të KSHPK-së. Procedura **u ndërpre, dhe lënda u arkivua** me vendimin e miratuar më datë 18. 5. 2020.

⁶ https://www.dsk.mk/fileadmin/user_upload/2020/odluki/2020-1588-2- Odluka.pdf

⁷ https://www.dsk.mk/fileadmin/user_upload/2020/odluki/2020-1263-3.pdf

⁸ https://www.dsk.mk/fileadmin/user_upload/2020/odluki/09-1071.pdf

Në këtë lëndë KSHPK **konstatoi shkelje** të nenit 63 paragrafi 1 "Ushtrimi i kompetencave diskrecionale" dhe nenit 67 paragrafi 1 i LPKKI "Keqpërdorim në kryerjen e veprimeve me interes publik" i cili përcakton se "person që kryen veprimtari me interes publik nuk duhet të keqpërdorë pozicionin e tij për realizimin e përfitimeve." Megjithëse kanë konstatuar shkelje të këtyre dispozitave të LPKKI, Komisioni Shtetëror e pezullon këtë lëndë sepse nuk ka kompetencë për procedim të mëtejshëm në lidhje me lëndën.

Kjo lëndë thekson çështjen, dhe kjo është mënyra se si procedurat për të cilat KSHPK-ja ka kompetencë të procedojë, jo vetëm punësimet, rregullohen me ligje të tjera dhe nëse ato sigurojnë rrjedhshmëri në përfundimin efektiv të procedurave për mangësitë dhe paligjshmëritë e identifikuar në sjelljen e funksionarëve të caktuar. Për më tepër, kjo hap dilemën për sanksionim, përkatësisht si të sigurohet, në mënyrë që veprimi i paligjshëm të përcaktohet dhe vërtetohet me fakte, të ndërmerret masë e përshtatshme për sanksionim.

Në këtë rast konkret, KSHPK pranoi qëndrimin e Bordit Mbikëqyrës të SHA Aerodromi se nuk ka kompetencë të veprojë për përcaktimin e përgjegjësisë të këtij lloji. Me këtë, lënda u kthye në KSHPK dhe këtu përfundoi me konkluzionin se KSHPK nuk ka bazë ligjore për veprim të mëtejshëm.

Në vend që të vendoset në evidencë si **lëndë në të cilin është konfirmuar keqpërdorimi i pushtetit**

diskrecional, lënda trajtohet si e mbyllur, e arkivuar dhe lëndë për të cilën nuk mund të bëhet asgjë më tej.

Në rastin konkret, duhet theksuar se:

1. Në këtë mënyrë, KSHPK-ja, lëshoi mundësinë të valorizojë punën e saj dhe të kërkojë tejkalim të mëtejshëm sistematik të këtyre problemeve.
2. KSHPK-ja, gjithashtu kishte mundësi të kërkojë nga SHA Aerodromi të rregullojë këto çështje me aktet e brendshme dhe të sigurojë mundësi për zgjidhjen e këtyre çështjeve në të ardhmen.
3. Analiza e kësaj lënde mund të publikohet në tërësi, në mënyrë që të ndahet përvoja dhe të ndërtohet praktikë ligjore në lidhje me keqpërdorimin e autorizimit diskrecional.
4. Në këtë kuptim, KSHPK-ja mund të bëjë edhe analizë të rrezikut nga korrupsioni në rregullativë dhe me akt formal nga Qeveria dhe ministria kompetente të kërkojë ndryshim të ligjeve përkatëse dhe aktet e tjera ligjore.
5. Sigurisht, KSHPK-ja, mund të sugjerojë edhe mundësinë e ekzistimit të tregtimit me ndikim.

Përfundime dhe rekomandime

Problemi i rrezikut nga korrupsioni gjatë punësimeve është shënuar në Programin e parë Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit të vitit 2003, ekzistojnë me vite dhe të njëjtat janë ri-inkorporuar si fushë horizontale me prioritet në Strategjinë e fundit Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit. Për tejkalimin e problemit nevojiten masa sistematike dhe vullnet të fortë politik.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit sot investon shumë burime dhe kohë në rastet që kanë të bëjnë me punësimet në sektorin publik. Mesatarisht, për secilën nga këto lëndë janë shpenzuar 250 ditë për kryerjen e kontrollit mbi gjendjen faktike. Është e qartë se kohëzgjatja e procedimeve ndikon mbi bllokimin e punës së Komisionit dhe merr një pjesë të konsiderueshme të kohës që mund t'i kushtohet kompetencave të tjera të Komisionit.

Kompetencat e Komisionit Shtetëror të përfshira në Ligjin për parandalimin e korrupsionit janë të shumta, përfshirë mundësinë për analiza anti-korrupsion të ligjeve dhe propozimin e zgjidhjeve të reja ligjore, por **komisioni duhet të forcojë rolin mbikëqyrës në zbatimin e ligjit në këtë fushë.**

KSHPK-ja, duhet të forcojë kapacitetet për të përdorur të gjitha mundësitë për vlerësimin e punës së saj dhe të kërkojë tejkalimin e mëtejshëm sistematik të këtyre

problemeve. **Procedimi për lëndë individuale dhe shfrytëzimi i mundësisë për lëndë konkrete të sugjerohet nevoja për korrigjim gjatë procedimit ose ligjeve, është shumë e rëndësishme për arritjen e ndryshimeve efektive.**

Puna e KSHPK-së, është shumë e rëndësishme për ndërtimin e praktikës ligjore në punën e institucioneve, por edhe të organeve hetimore dhe gjykatave. Analizat e lëndëve individuale, për të cilat zakonisht kryhet i ashtuquajtur "hetim administrativ", mund të publikohen në tërësi, me qëllim që të ndahet përvoja dhe menjëherë të kërkojnë zgjidhje, si për shembull në rastet e tejkalimit të kompetencave diskrecionale.

Kompetenca e KSHPK-së, për analizën e rrezikut nga korrupsioni në rregullativën dhe në këtë situatë tregohet si thelbësore dhe mundëson KSHPK me akt formal, bazuar në rast konkret nga Qeveria dhe ministria kompetente të kërkojë ndryshime në ligjet përkatëse dhe aktet të tjera juridike.

Sigurisht, për këtë nevojiten kapacitete dhe gatishmëri për bashkëpunim me subjekte të tjera, jo vetëm në pushtetin ekzekutiv por edhe në sektorin joqeveritar, i cili mund të kompensojë një pjesë të këtyre mangësive në kuadër të projekteve të tij.

